



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2021:223556

Datë: 06.07.2022

Numri i dokumentit: 03206161

K. Nr. 999/21

Gjykata Themelore Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni për Kundërvajtje, Gjyqtari Menderes Behluli, duke vendosur në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit P.J nga fsh. ...K. Viti, për shkak të veprës kundërvajtëse të paraparë dhe sanksionuar me dispozitat e nenit 36 paragrafi 3, të Ligjit mbi Pyjet nr- 2003/3, Ligjit nr-2004/29 dhe nenit 14, të Ligjit nr., 03/L 153/2010, mbi ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr, 2003/3 për Pyjet e Kosovës i Kuvendit të Kosovës, e konform nenit 55 pika 1 dhe 2, 86, 119, dhe 124, të Ligjit mbi Kundërvajtjet, me datë **06.07.2022** shpallë këtë:

A K T G J Y K I M

Kundër të pandehurit P.J nga babai....., i lindur me datë....., në fsh..... K. Viti, ku edhe jeton, shqipëtar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë P Ë R G J E G J Ë S

Sepse me datën **30.08.2021** rreth orës **14:20min**, është takuar në territorin e fshatiti Vogël në vendin e quajtur “”, duke prerë dru Ahu të njoma, me sharr motorrike, 28 copë, me diametër **12-15** cm, dhe gjatësi **6** m, të cilat i ka shkurtuar nga 1m, të cilat i transportonte me traktor “**IMT39**” me ram, dhe i njëjti është recidivist, e që ika shkatuar dëm Agjensionit Pyjor më shumë prej **248.32** euro

- me ç ‘veprim ka kryer veprën kundërvajtëse, të paraparë dhe sanksionuar me dispozitat e nenit 36 paragrafi 3, të Ligjit mbi Pyjet nr- 2003/3, Ligjit nr-2004/29 dhe nenit 14, të Ligjit nr. 03/L 153/2010, mbi ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr, 2003/3, për Pyjet e Kosovës i Kuvendit të Kosovës, andaj

D Ë N O H E T

Me dënim me gjobë në larësi prej **200 (dyqind) €**, të cilën gjobë i pandehuri është i obliguar ta paguaj në afatin prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë në kuptim të nenit 163p. 3 të LK.

I pandehuri obligohet që në emër të paushallit gjyqësor t'i paguajë kësaj gjykate shumën prej **5 €**, në afat të njëjtë sikurse gjobën, konform nenit 109 paragrafi I pika 6, të LMK-së.

Nga një kopje e aktgjykimit t'iu dorëzohet palëve në procedurë.

A r s y e t i m

A.P.K-ja, në Gjilan, me datën **22.09.2021**, ka paraqitur kërkesën me nr. **163/21**, për inicimin e procedurës kundërvajtëse, kundër të pandehurit të lartëshënuar dhe ka kërkuar që i njëjti të shpallet fajtor dhe ndëshkohet sipas ligjit.

Gjyqtari shqyrtoi kërkesën dhe konstatoi se e njëjta është e ligjshme.

Gjykata me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike mori në pyetje të pandehurin i cili deklaroi se është e vërtetë se me datë **30.08.2021** në ora 14:20 min, ka qenë në pyll shtetëror, në vendin e quajtur "**Gashtica**", për ti marr disa dru kryesisht të mbledhura nëpër mal, nuk e përjashton mundësin se e ka parë donje të thyer nga fryma, qëllimi i marrjes ishte për shfrytëzimin e nevojave familjare, kërkon ndjesë kërkon falje, me që është i pa punë, lut gjykatën që kësaj here ti shqiptoj një dënim sa më të vogël minimal.

Gjyqtari për vërtetimin e gjendjes faktike mori në pyetje edhe personin zyrtar, pylltarin Naim Rrustemi, në cilësinë e dëshmitarit i cili deklaroi se është e vërtetë se me datë **30.08.2021**, në orën **14:20min**, të lartpërmendurin e kam takuar në territorin e fshatit Goden i Vogël, në vendin e quajtur "**Gashtica**", duke prerë me sharrë motorrike dru të njoma Ahu, ku kishte prerë 28 copa, me diametër **12-15** cm, me gjatësi 6 m, dhe i transportonte me traktor "**IMT 39**" me ram.

Andaj gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, deklaratës së të pandehurit dhe deklaratës së dëshmitarit erdhi në përfundim se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë prova të mjaftueshme, se i pandehuri është kryerës i veprës kundërvajtës prerje dhe-transportimi ilegal i druve, vepër kjo e paraparë dhe sanksionuar me dispozitat e nenit 36 paragrafi 3, të Ligjit mbi Pyjet nr- 2003/3, Ligjit nr-2004/29 dhe nenit 14, të Ligjit nr. 03/L 153/2010, mbi ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr, 2003/3 për Pyjet e Kosovës të aprovuar nga Kuvendit i Kosovës, për të cilën të njëjtin e shpalli përgjegjës dhe e ndëshkoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjyqtari me rastin e shqiptimit të dënimit, pati parasysh peshën dhe pasojat e veprës kundërvajtëse, rrethanat lehtësuese dhe rënduese konform nenit **31 p 1 të LMK-së**, dhe të njëjtit i shqiptoi këtë dënim nën minimumin e paraparë ligjor konform nenit **35 të LMK-së**,

me bindje se edhe me një dënim të këtillë do të arrihet efekti i dënimit tek i pandehuri që në të ardhmen mos të kryej vepra të tilla kundërvajtëse .

I pandehuri obligohet që në emër të paushallit gjyqësor t'i paguajë kësaj gjykate shumën prej 5 €, në afat të njëjtë sikurse gjobën, konform nenit 109 paragrafi I pika 6, të LMK-së.

Nga të cekurat e mësipërme u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

**Gjykata Themelore Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm
Divizioni për Kundërvajtje,
Me datë 06.07.2022**

Praktikantja,
Vjollca Shabani

Gjyqtari,
Menderes Behluli

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit Divizioni për Kundërvajtje në Prishtinë, në afat prej 8 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi. Ankesa dorëzohet përmes kësaj gjykate.